



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të KQZ-së, në përbërje prej: Betim Xhema-Kryesues, Jehona Cami-anëtare dhe Igor Cirkovic-Anëtar, duke rivendosur në lidhje me Ankesën nr.09/446-2023, të dt.19.04.2023, për Anulimin e Vendimit me numër 02-396-2023, të datës 07.04.2023, të paraqitur nga Leotrim Arifaj, sipas obligimit që del nga Vendimi i Këshillit të Pavarur Mbikqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 26.07.2023 nr.5361/2023, të pranuar në Arkivën e KQZ-së me datë 28.07.2023, me nr. 857-09-2023, pas mbajtjes së shqyrtimit me datë 09.08.2023, mori këtë:

VENDIM

- I. **Aprovohet** si e bazuar Ankesa me Nr. 09/446-2023 e datës 19.04.2023 e parashtruar nga ankuesi Leotrim Arifaj, për Anulimin e Vendimit me numër 02-396-2023 i datës 07.04.2023.
- II. **Anulohet** Vendimi Nr.02-396-2023 i datës 07.04.2023 i Kryeshefit Ekzekutiv të Sekretariatit Qendror të Zgjedhjeve, për Anulimin e Konkursit me Numër reference KQZ-05/2023: Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Mamushë.
- III. **Mbetet në fuqi** Njoftimi për kandidatin e suksesshëm Leotrim Arifaj për pozitën Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Mamush i datës 10.03.2023, si dhe çdo veprim procedural i ndërmarr deri në nxjerrjen e Vendimit Nr. 02-396-2023 i datës 07.04.2023 i Kryeshefit Ekzekutiv të Sekretariatit Qendror të Zgjedhjeve.

A r s y e t i m

Parashtruesi i ankesës Leotrim Arifaj ka paraqitur Ankesën nr. 09-446-2023, me dt. 19.04.2023, me kërkesën për Anulimin e Konkursit me numër 02-396-2023, të datës 07.04.2023.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të KQZ-së, në bazë të Udhëzimit Administrativ (KQZ) Nr.02/2018 për Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave në Sekretariatit të KQZ-së, me dt. 09.08.2023, sipas obligimit që del nga Vendimi i Këshillit të Pavarur Mbikqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje KPMSHC) të datës 26.07.2023 nr.5361/2023, të pranuar në Arkivën e KQZ-së me datë 28.07.2023, me nr. 857-09-2023, ka filluar me rishqyrtimin e ankesës nr. 09-446-2023 të parashtruar nga ankuesi Leotrim Arifaj, duke rishqyrtuar këto prova:

1. Konkursin për pozitën KQZ-05/2023: Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Mamushë, i datës 27.01.2023;

2. Njoftimi për kandidatin e suksesshëm të datës 10.03.2023;
3. Ankesen e parashtruesit të Ankesës Leotrim Arifaj me nr 09-446-2023, dt. 19.04.2023;
4. Aplikacionin e të përzgjedhurit për pozitën Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Mamush, Leotrim Arifaj;
5. Korespodencat e realizuara në mes të Zyrës së personelit dhe kandidatit të përzgjedhur Leotrim Arifaj;
6. Kontratën mbi shfrytëzimin e paluajtshmërisë me qira të kandidatit të përzgjedhur Leotrim Arifaj;
7. Certifikatën mbi njohjen e gjuhës turke të kandidatit të përzgjedhur Leotrim Arifaj, niveli A1;
8. Transaksionet e konsumatorit për energji elektrike;
9. Verifikimin e Qendrës së votimit për kandidatin e përzgjedhur Leotrim Arifaj për zgjedhjet e vitit 2017, 2019, dhe 2021;
10. Rregulloren Nr.03/2017 per Procedurën e Rekrutimit, Emërimit dhe punës provuese të nëpunësve në Sekretariatit e KQZ-së.
11. Raportin e Komisionit përzgjedhës për vlerësimin e testeve me shkrim për pozitën KQZ-02/2020 Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Mamush, i datës 03.03.2023;
12. Raport nga Kryesuesi i Komisionit përzgjedhës mbi përgatitjen e listës së ngushtë për pozitën KQZ-02/2020 Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Mamush, i datës 03.03.2023;
13. Raport nga Kryesuesi i Komisionit përzgjedhës mbi përgatitjen e listës së ngushtë për pozitën KQZ-02/2020 Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Mamush, i datës 23.02.2023;
14. Raporti final i rekomandimit nga Komisioni rekrutues, i datës 07.03.2023;
15. Kërkesen për Arovimin e Rekomandimit të Komisionit përzgjedhës për pozitën: KQZ- 05/2023, Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Mamush;
16. Deklaratë nën betim, Feta Mazrek, numër protokolli 09-381-2023, datë 07.04.2023;
17. Vendim për anulimin e konkursit me numër reference KQZ-05/2023: Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Mamush, datë 07.04.2023.
18. Ligjin për përdorimin e gjuhëve Nr, 02/L-37;
19. Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës: Nr.03/073;
20. Ligji për Regjistrin Qendror të Gjendjes Civile;
21. Shkresa numër prot. 09/334/2-2023, datë 02.08.2023 (Përgjigje nga Policia e Kosovës në kërkesën e Kryeshefit Ekzekutiv).

22. Vendimi i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të KQZ-së nr. 08/27-658-2023.

Komisioni pasi ka shqyrtuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha provat së bashku, si dhe bazuar në rezultatin e tërësishëm të shqyrtimit të lëndës, konstatoi se:

Në pretendimin e ankuesit se citimi i nenit 1.2 të Ligjit për përdorimin e gjuhëve nga ana e Kryeshefit Ekzekutiv në vendimin për anulimin e konkursit, citoi” “Bazuar në Ligjin Nr. 02/L-37, për përdorimin e gjuhëve neni 1.2, në nivel komunal, gjuhët e tjera të bashkësive, si gjuha turke, boshnjake dhe rome, janë gjuhë në përdorim zyrtar, sipas kushteve të përcaktuara me ligj” është i paqëndrueshëm, Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave duke shqyrtuar faktet, konkretisht Vendimin e datës 27.01.2023 me nr. 01-95-2023 për miratimin e planit të rekrutimit, dhe në bazë të saj shpalljen e Konkursit për plotësimin e vendeve të lira të punës KQZ-05/2023 Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Mamushë, tek Kualifikimi, aftësitë dhe përvoja e punës, pika 7. Njohja e gjuhës tjetër zyrtare konsiderohet si përparësi. Nga shikimi i shkresave të lëndës Komisioni konstaton se kërkesat e konkursit për dokumentacionin e kandidatëve janë në pajtim me nenin 14, paragrafi 1 dhe 2 i Rregullores 03/2017 për Procedurat e Rekrutimit, Emërimit dhe punës provuese në Sekretariatit e KQZ-së Në bazë të Rregullores për përdorimin e gjuhëve në Komunën e Mamushës Nr.01/21. Data 26.05.2009, neni 2 thotë “Gjuha shqipe dhe gjuha serbe si gjuhë zyrtare në Kosovë dhe gjuha Turke në Komunën e Mamushës kanë status të barabratë sa i përket përdorimit të tyre në të gjitha organet institucionet komunale të Komunës”. Ndërsa në rregulloren 03/2017 nuk ka ndonjë normë juridike që rregullon në mënyrë të posaçme rekrutimin në komunat ku janë në përdorim zyrtar edhe gjuhët tjera përveç gjuhës shqipe dhe serbe, konkretisht që kërkon njohjen obligative të gjuhës tjetër zyrtare, por një gjë të tillë e njuh vetëm në nivel të përparësisë. Rrjedhimisht Komisioni gjen se ky pretendim ankimor është i qëndrueshëm dhe konstaton se Rregullorja 03/2017 për Procedurat e Rekrutimit, Emërimit dhe punës provuese në Sekretariatit e KQZ-së duke mos përmbajtur rregulla specifike lidhur me kriteret gjuhësore në konkurs sa i përket gjuhëve zyrtare që janë në përdorim në komunat ku janë në përdorim zyrtar edhe gjuhët tjera përveç asaj shqipe dhe serbe, është e mangët dhe krijon konfuzion. Ky pretendim ankimor i cili është theksuar nga ana e Komisionit, është vlerësuar se ka qenë i drejtë edhe nga ana e Kolegjit të KPMSHC-së, të cilët theksojnë poashtu se “Po ashtu, Kolegji i Këshillit ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër 08/27-658-2023 të datës 17.05.2023 ka vepruar drejtë kur e ka aprovuar pretendimin ankimor të ankuesit se nuk ka qenë obligative njohja e gjuhëve të tjera zyrtare, pasi që sipas konkursit të datës 30.01.2023 për pozitën me shifër "KQZ-05/2023Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Mamushë", në pikën 4 dhe 6 lidhur me kriteret e konkursit është përcaktuar si në vijim: "4. Shkathtësi të shkëlqyera ne; komunikim me gojë dhe me shkrim në njërën nga gjuhët zyrtare; 6. Njohja e gjuhës tjetër zyrtare konsiderohet si përparësi", prandaj mbështetur mbi këtë konstatim del se nuk ka qenë obligative njohja e gjuhës turke në

rastin konkret, madje në konkursin në fjalë nuk është kërkuar të paraqiten dëshmi për njohjen e gjuhës turke”.

Në pretendimin e ankuesit se Vendimi i datës 07.04.2023 me numër 02-396-2023 i Kryeshefit Ekzekutiv të KQZ-së është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative sepse nuk përmban udhëzimin apo këshillën juridike për përdorimin e mjeteve juridike administrative të rregullta e që është ankesa, Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave konstaton se vet fakti i shqyrtimit të kësaj ankese nga ky Komision, nënkupton se parashtruesit të ankesës nuk i është mohuar e drejta e ushtrimit të ankesës, ashtu që në seancën e parë të këtij Komisioni të mbajtur me datë 27.04.2023, Ankesa e parashtruesit është lejuar si e afatshme, e lejueshme dhe Komisioni është kompetent për shqyrtimin e saj, duke u bazuar në Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative, konkretisht neni 124 dhe 127 i këtij ligji.

Pretendimi ankimor në lidhje me Deklaratën e z.Feta (Adem) Mazrek, se i njejtë me asnjë provë nuk e ka dëshmuar se e ka shkëputur kontratën e qirasë me ankuesin, ashtu siç është përcaktuar me dispozitat ligjore të ligjit të detyrimeve, Komisioni ka shqyrtuar Deklaratën nën betim, nga personi Feta (Adem) Mazrek, e protokoluar në SKQZ me nr. prot.09-381-2023, dt. 07.04.2023, ku ai deklaroi nën betim se “Unë Feta Mazrek kam lidhur kontratë me qiramarrësin Leotrim (Ramiz) Arifaj me nr. LRP.nr.256/2021 por që e vërteta e kësaj qështje është se qiramarrësi Leotrim Arifaj nuk ka jetuar në asnjë moment në shtëpinë time në nr të gastrës kadastrale P-73213054-00841-2 me sipërfaqe prej 848m2. Përveqse me datë 08.12.2021 në Prizren e kemi lidhur këtë kontratë, pos as para lidhjes së Kontratës e as pas lidhjes së Kontratës mbi qiranë me LRP.nr.256/2021 nuk ka banuar e as qëndruar në shtëpinë e cila është lëshuar me qira nga ana ime si pronar i shtëpisë”. Komisioni poashtu ka shqyrtuar Vendimin e KPMSHC-së e cila thotë se “prandaj në rrethanat e rastit konkret Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave ka vepruar gabimisht kur ia ka falur besim vetëm njëres provë, respektivisht deklaratës së dhënë nga personi EM, rrjedhimisht nuk ka arritur të konstatojë drejtë gjendjen faktike, pasi që sipas kopjes së letërnjoftimit të ankuesit të lëshuar me datë 13.12.2021 dëshmohet se vendbanimi i ankuesit është në Mamushë, prandaj mbështetur në dispozitat e nenit 7 paragrafi 7.1.a dhe 7.3 të Ligji Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, duke qenë se Komisioni i Ankesave është organ që vepron në kuadër KQZ-së ka mundur të kërkojë nga personat përgjegjës brenda institucionit që të bëjë verifikimin nëse ankuesi sipas letërnjoftimit të paraqitur ka të drejtë vote në Komunën e Mamushës, mirëpo nga arsyetimi i goditur përmes kësaj ankese konstatohet fakti se një veprim të tillë procedural me qëllim të konstatimit të drejtë të gjendjes faktike Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave nuk e ka ndërmarrë në mënyrën e duhur, pasi që përmes emalit të datës 23.03.2023 dërguar nga zyrtari P.R "Zyrtar i Lartë i bazës së të Dhënave" për Kryeshefin Ekzekutiv të Sekretariatit të KQZ-së ishte dëshmuar se ankuesi për zgjedhjet e vitit 2017, 2019 dhe 2021 ka qenë pjesë e listës votuese në Komunën e

Suharekës, mirëpo komisioni në fjalë është dashur ta ketë parasysh faktin se azhurnimi i listës së votuesve lidhur me zgjedhjet e fundit lokale për vitin 2021 të mbajtura me datë 17.10.2021, logjikisht më së voni ka mundur të azhurnohet deri në të njëjtën datë, pra datën e mbajtjes së zgjedhjeve, kurse data e lëshimit të letërnjoftimit të ankuesit është e mëvonshme respektivisht data 13.12.2021, sikurse është i njohur fakti se marrëdhënia e punë lidhet për të ardhmen, madje edhe konkursi është shpallur me datë 31.01.2023, prandaj Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave e ka vërtetuar gabimisht gjendjen faktike pasi që nuk ka arritur të konstatoi saktë qendrën e votimit të ankuesit në kohën e aplikimit sipas konkursit të datës 31.01.2023". Po ashtu, Komisioni ka shqyrtuar shkresën nr. prot. 09-334/2/2023 e cila është email nga Kolonel Agron Nezaj, Drejtor i Departamentit të Hetimeve, Policia e Kosovës, ku thuhet se: "Bazuar në kërkesën Tuaj, Ju njoftojmë se nga Policia e Kosovës nga verifikimet e kryera në sistemin informativ të PK-së dhe bazës së të dhënave inteligjente, nuk posedojmë të dhëna të raportuara në cilësi të të dyshuarit për personin L.A. i lindur me 20/07/1987, me nr. personal 1171563697, me adresë banimi ne fsh. Peqan — KK Suharekë dhe adresë tjetër e raportuar në KK-Mamushë.

Sa i përket regjistrimit te adresës së banimit, subjekti sipas gjendjes civile nga data 08/12/ 2021 figuron me adresë vendbanimi në KK-Mamushë, ndërsa më herët adresë e vendbanimit i figuron Fsh: Peqan-KK Suharekë".

Duke ritrajtuar pretendimin ankimor të ankuesit që anulimi i konkursit është tendencioz dhe i pa bazuar në ligjin për shërbimin civil, dhe rregulloren 02/2010, dhe deklarin që është fakt notor që në momentin e aplikimit e ka pasur të gjithë dokumentacionin e kompletuar sipas kushteve dhe kriterëve të konkursit të dates 30.01.2023, nga rishqyrtimi i shkresave të lëndës gjen se qëndron fakti që ankuesi në momentin e aplikimit e ka pasur të gjithë dokumentacionin e kompletuar sipas kushteve dhe kriterëve të konkursit. Kriteret e konkursit janë përcaktuar në bazë të Rregullores 03/2017 për Procedurat e Rekrutimit, Emërimit dhe punës provuese në Sekretariatit e KQZ-së, dhe duke qenë së në konkurs të datës 31.01.2023 për pozitën "Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Mamushë" ndër të tjera është parapara që "Kandidatët të cilët aplikojnë për pozita "Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve" duhet të jenë persona me të drejtë vote në komunat e tyre përkatëse", dhe ndërlidhur me këtë duke e trajtuar dhe marr për bazë Vendimin e KPMSHC-së 5361/2023, ku thuhet "Kolegji i Këshillit me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit, ka analizuar shpalljen e konkursit të datës 31.01.2023 për pozitën "Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Mamushë" ku ndër të tjera është paraparë si kriter që "Kandidatët të cilët aplikojnë për pozita Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve (ZLKGJ) duhet të jenë persona me të drejtë vote në komunat e tyre përkatëse", nga rrjedh se kandidatët për pozitën e lartcekur duhet të jenë persona me të drejtë vote në komunën përkatës , pra të jenë të evidentuar në listën e votuesve të komunës përkatëse e Cila mirëmbahet dhe aranzhohet nga KQZ, sikurse përcaktohet me nenin 7 paragrafi 7.1 dhe 7.3 të Ligji Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës theksohet së "

7.1 KQZ-ja mban Listën e Votuesve dhe siguron që Lista e Votuesve është e saktë dhe e azhuruar, dhe e njëjta përmban: a) ekstraktin ITIë të vonë në dispozicion nga Regjistri Qendror Civil i të gjithë votuesve me të drejtë vote të cilët janë regjistruar si qytetar të Kosovës sipas Ligjit për Shtetësinë; b) të gjithë votuesit me të drejtë vote jashtë Kosovës të cilët në mënyrë të suksesshme kanë aplikuar për votim jashtë Kosovës. 7.3 Për konfirmimin e të drejtës për votim, KQZ-ja ka qasje në regjistra, të dhëna për vendbanim dhe të dhëna të tjera zyrtare.", mirëpo nga shkresat e ofruara në cilësi të provave të dërguara në Këshill përmes shkresës së datës 14.06.2023, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka bashkangjitur edhe kopjen e letërnjoftimit të ankuesit me Nr. Personal:1171563697 dhe numër të ID2020637 i lëshuar me datë 13.12.2021, sipas së cilit dokument konstatohet fakti se vendbanimi i ankuesit është në Mamushë, prandaj në rrethanat e rastit konkret Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave ka vepruar gabimisht kur ia ka falur besim vetëm njëërës provë, respektivisht deklaratës së dhënë nga personi EM, rrjedhimisht nuk ka arritur të konstatojë drejtë gjendjen faktike, pasi që sipas kopjes së letërnjoftimit të ankuesit të lëshuar me datë 13.12.2021 dëshmohet se vendbanimi i ankuesit është në Mamushë, prandaj mbështetur në dispozitat e nenit 7 paragrafi 7.1.a dhe 7.3 të Ligji Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, duke qenë se Komisioni i Ankesave është organ që vepron në kuadër KQZ-së ka mundur të kërkojë nga personat përgjegjës brenda institucionit që të bëjë verifikimin nëse ankuesi sipas letërnjoftimit të paraqitur ka të drejtë vote në Komunën e Mamushës, mirëpo nga arsyetimi i goditur përmes kësaj ankese konstatohet fakti se një veprim të tillë procedural me qëllim të konstatimit të drejtë të gjendjes faktike Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave nuk e ka ndërmarrë në mënyrën e duhur, pasi që përmes emailit të datës 23.03.2023 dërguar nga zyrtari P.R "Zyrtar i Lartë i bazës së të Dhënave" për Kryeshefin Ekzekutiv të Sekretariatit të KQZ-së ishte dëshmuar se ankuesi për zgjedhjet e vitit 2017, 2019 dhe 2021 ka qenë pjesë e listës votuese në Komunën e Suharekës, mirëpo komisioni në fjalë është dashur ta ketë parasysht faktin se azhurnimi i listës së votuesve lidhur me zgjedhjet e fundit lokale për vitin 2021 të mbajtura me datë 17.10.2021, logjikisht më së voni ka mundur të azhurnohet deri në të njëjtën datë, pra datën e mbajtjes së zgjedhjeve, kurse data e lëshimit të letërnjoftimit të ankuesit është e mëvonshme respektivisht data 13.12.2021, sikurse është i njohur fakti se marrëdhënia e punë lidhet për të ardhmen, madje edhe konkursi është shpallur me datë 31.01.2023, prandaj Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave e ka vërtetuar gabimisht gjendjen faktike pasi që nuk ka arritur të konstatoi saktë qendrën e votimit të ankuesit në kohën e aplikimit sipas konkursit të datës 31.01.2023".


Më tutje në Vendimin e KPMSHC-së 5361/2023, thuhet se "Kolegji i Këshillit thekson faktin se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave me rastin e rishqyrtimit dhe rivendosje së lëndës së ankuesit sipas ankesës së datës 19.04.2023, duhet të ndërmarrë të gjithë veprimet e nevojshme sikurse përcaktohet me dispozitat e nenit nenin 7 paragrafi 7.1.a të Ligji Nr. 03/1--073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës theksohet së " 7.1 KQZ-ja mban Listën e Votuesve dhe siguron që Lista e Votuesve është e saktë dhe e azhuruar, dhe e njëjta përmban: a) ekstraktin

më të vonë në dispozicion nga Regjistri Qendror Civil i të gjithë votuesve me të drejtë vote të cilët janë regjistruar si qytetar të Kosovës sipas Ligjit për Shtetësinë' me qëllim të konstatimit të saktë se cili ka qenë apo cili mund të jetë vendvotimi i ankuesit në momentin e aplikimit në konkursin e datës 31.01.2023, si dhe duhet të eliminoj apo marr përbazë vërejtjet e dhëna juridike nga pikëpamjet e këtij vendimi”.

Nga sa u theksua më sipër, Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave duke u bazuar në nenin 9 të Udhëzimit Administrativ (KQZ) Nr.02/2018 për Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave në Sekretariatit e KQZ-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër Vendimit Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, palët e pakënaqura me këtë vendim, kanë të drejtë të ushtrojnë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit.*

Betim Xhema


Kryesues i Komisionit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit;
- Zyrës së Personelit;
- Kryeshefit të SKQZ-së, dhe
- Arkivës së KQZ-së.
- KPMSHC-së